

"HYDROBORSH" sh.p.k

Pasqyrat financiare per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31.12.2010 dhe shenimet shpjeguese

Shumat shprehen ne leke, perndryshe shkruhet

	AKTIVET	Shenime	2010	2009
<b>I</b>	<b>Aktivet Afatshkurtera</b>			
<b>1</b>	<b>Aktivet Monetare</b>	<b>1</b>		
	Societe Generale Albania		1,598,502	1,070,828
	Arka		983,073	
	<b>Totali 1</b>		<b>2,581,575</b>	<b>1,070,828</b>
<b>2</b>	<b>Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim</b>	<b>2</b>		
i	Derivatet	3	-	-
ii	Aktivet e mbajtura per tregtim	4	-	-
	<b>Totali 2</b>		-	-
<b>3</b>	<b>Aktive te tjera financiare afat-shkurtera</b>	<b>5</b>		
i	Llogari/Kerkesa te arketueshme	6	3,323,454	-
ii	Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	7	-	-
iii	Instrumente te tjera borxhi	8	-	-
iv	Investime te tjera financiare	9	-	-
	<b>Totali 3</b>		<b>3,323,454</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Inventari</b>	<b>10</b>		
i	Lendet e para	11	-	-
ii	Prodhim ne proces	12	-	-
iii	Produkte te gatshme	13	-	-
iv	Mallra per nshitje	14	-	-
v	Parapagesat per furnizime	15	-	-
	<b>Totali 4</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Aktivet biologjike afat-shkurtera</b>	<b>16</b>	-	-
<b>6</b>	<b>Aktivet afatshkurtera te mbajtura per shitje</b>	<b>17</b>	-	-
<b>7</b>	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>	<b>18</b>	-	-
	<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtera (I) (1-7)</b>		<b>5,905,028</b>	<b>1,070,828</b>
<b>II</b>	<b>Aktivet afatgjata</b>	<b>19</b>		
<b>1</b>	<b>Investimet financiare afatgjata</b>	<b>20</b>		
i	Pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	21		
ii	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	22		6,209,584
iii	Aksione dhe letra te tjera me vlere	23		
iv	Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata	24		
	<b>Totali 1</b>		<b>0</b>	<b>6,209,584</b>
<b>2</b>	<b>Aktivet afatgjata materiale</b>	<b>25</b>		
i	Toka	26	-	-
ii	Ndertesat	27	-	-
iii	Pajsje informatike & zyre	28	840,242	
	Amortizimi		-153,155	-
iv	Aktive te tjera afatgjata materiale (me vlere kontabile)	29	-	-
	Aktive afatgjata ne proces		21,027,124	-
	<b>Totali 2</b>		<b>21,714,210</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Aktivet biologjike afat-gjata</b>	<b>30</b>	-	-
<b>4</b>	<b>Aktivet afatgjata jomateriale</b>	<b>31</b>		
i	Emri i mire	32	-	-
ii	Shpenzimet e zhvillimit	33	-	-
iii	Aktive te tjera afatgjata jomateriale	34	-	-
	Amortizimi		-	-
	<b>Totali 4</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	Kapital aksionar i papaguar	35	-	-
	Aktive te tjera afatgjata	36	-	-
	<b>Totali i Aktiveve Afatgjata (II) (1-6)</b>		<b>21,714,210</b>	<b>6,209,584</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>		<b>27,619,238</b>	<b>7,280,413</b>

**Pasqyrat financiare per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31.12.2010 dhe shenimet shpjeguese**

*Shumat shprehen ne leke, perndryshe shkruhet*

	<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>Shenime</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
<b>I</b>	<b>Detyrimet Afatshkurtera</b>			
<b>1</b>	<b>Derivative</b>	<b>37</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Huamarrjet</b>	38		
<i>i</i>	<i>Huat dhe obligacionet afatshkurtera</i>	39	0	0
<i>ii</i>	<i>Kthimet/Ripagesat e huave afatgjata</i>	40		
<i>iii</i>	<i>Bono te konvertueshme</i>	41	0	0
	<b>Totali 2</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Huat dhe parapagimet</b>	42		
<i>i</i>	<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	43	0	
<i>ii</i>	<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	44	750,189	270,000
<i>iii</i>	<i>Detyrime tatimore</i>	45	116,462	10,000
<i>iv</i>	<i>Hua te tjera</i>	46		
	<i>Te drejta e detyrime ndaj ortakeve</i>		25,618,155	6,900,000
<i>v</i>	<i>Parapagimet e arketuara</i>	47		0
	<b>Totali 3</b>		<b>26,484,806</b>	<b>7,180,000</b>
<b>4</b>	<b>Grantet dhe te ardhurat e shtyra</b>	48	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Provizionet afatshkurtera</b>	49	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatshkurtera (I) (1-5)</b>		<b>26,484,806</b>	<b>7,180,000</b>
<b>II</b>	<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>50</b>		
<b>1</b>	<b>Huat afatgjata</b>	51		
<i>i</i>	<i>Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare</i>	52		
<i>ii</i>	<i>Bonot e konvertueshme</i>	53	0	0
	<b>Totali 1</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Huamarrje te tjera afatgjata</b>	54		
<b>3</b>	<b>Provizione afatgjata</b>	55		<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Grantet dhe te ardhurat e shtyra</b>	56		<b>0</b>
	<b>Totali i detyrimeve Afatgjata (II) (1-4)</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>26,484,806</b>	
<b>III</b>	<b>Kapitali</b>	<b>57</b>	<b>100,000</b>	<b>100,000</b>
<b>1</b>	<b>Aksionet e pakices (perdoret vetem per pasqyrat financiare te konsoliduara)</b>			<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Kapitali qe i perket aksionereve te shoqerise meme (perdoret vetem ne PF te konsoliduara)</b>	58		<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	59		<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Primi i aksionit</b>	60	100,000	100,000
<b>5</b>	<b>Njesite ose aksionet e thesarit (negative)</b>	61		<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Rezerva statusore</b>	62		<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	63		
<b>8</b>	<b>Rezerva te tjera</b>	64		
<b>9</b>	<b>Fitimet e pashperndara</b>	65	413	
<b>10</b>	<b>Fitimi (humbja) e vitit financiar</b>	66		
		67	1,034,020	413
	<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>1,134,433</b>	<b>100,413</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT</b>		<b>27,619,238</b>	<b>7,280,413</b>

**Pasqyrat financiare per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31.12.2010 dhe shenimet shpjeguese**

Shumat shprehen ne leke, perndryshe shkruhet

**2.Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen 01.01.2010 deri me 31.12.2010**

Nr	Pershkrimi i elementeve	Shenime	Viti ushtrimor 31.12.2010	Viti ushtrimor 31.12.2009
1	Shitjet neto		-	-
2	Te ardhurat e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		1,067,674	-
3	Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces.		-	-
4	Materialet e konsumuara		-	-
5	Kosto e punes (i+ii+iii)		-	-
i	Pagat e personelit		-	-
ii	Tjera personeli		-	-
iii	Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore		-	-
6	Amortizimi dhe zhvleresimet		-	-
7	Shpenzime te tjera		-	-
8	<b>Totali i Shpenzimeve (4-7)</b>		-	-
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-8)		1,067,674	-
10	Investimet financiare afatgjata		-	-
11	Te ardhurat dhe shpenzimet nga pjesemarrjet		-	-
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare:		-	-
12.1	Te ardhura dhe shpenzime financiare nga investime te tjera financiare afatgjata		-	-
12.2	Te ardhura dhe shpenzime nga interesi		3,028	-
12.3	Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit		78,210	413
12.4	Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare			
13	<b>Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve (12.1+12.2+12.3+12.4)</b>		81,238	413
14	<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+11+13)</b>		1,148,911	413
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		114,891	-
#	<b>Fitimi (humbja) neto i vitit financiar (14-</b>		<b>1,034,020</b>	<b>413</b>
17	Elementet e pasqrave te konsoliduara			

Pasqyrat financiare per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31.12.2010 dhe shenimet shpjeguese

Shumat shprehen ne leke, perndryshe shkruhet

Nr	PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	2010	2009
<b>I</b>	<b>Fluksi parave nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		
1	Parate e arketuara nga klientet	-	-
2	Parate e paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve	(16,246,194)	(5,829,585)
3	Parate e ardhura nga veprimtarite	-	-
4	Interesi I paguar	-	-
5	Tatim fitimi I paguar	(124,000)	-
	<b>Paraja neto nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>(16,370,194)</b>	<b>(5,829,585)</b>
<b>II</b>	<b>Fluksi I parave nga veprimtarite investuese</b>		
1	Blerja e komp se kontroll X minus parate e arketuar	-	-
2	Blerja e Aktiveve afatgjata materiale	(840,242)	-
3	Te Ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
4	Interesi I arketuar	3,028	413
5	Dividente te arketuar		
	<b>Paraja neto e perdorur nga veprimtar investuese</b>	<b>(837,214)</b>	<b>413</b>
<b>III</b>	<b>Fluksi parave nga veprimtarite financiare</b>		
1	Te Ardhura nga emetimi kapitalit aksioner		100,000
2	Te Ardhura nga Huamrrjet afatgjata	18,718,155	6,800,000
3	Pagesat e detyrimeve afatgjata		
4	Dividente te paguar		
	<b>Paraja neto e perdorur ne veprimtar financiare</b>	<b>18,718,155</b>	<b>6,900,000</b>
	<b>Rritja/renia neto e mjeteve monetare</b>	<b>1,510,747</b>	<b>1,070,828</b>
	<b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>	<b>1,070,828</b>	<b>-</b>
	<b>Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel</b>	<b>2,581,575</b>	<b>1,070,828</b>

**Pasqyrat financiare per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31.12.2010 dhe shenimet shpjeguese**

*Shumat shprehen ne leke, perndryshe shkruhet*

*Pasqyra e ndryshimit te Kapitalit qjate periudhes 1 Janar 2010 deri me 31 Dhjetor 2010*

**Kapitali aksionar qe i perket aksionereve te shoqerise meme**

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksionet e thesarit	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva te konvertimit te monedhave te huaja	fitimi i pashperndare	Rezerva te tjera	Shuma te parashikuara per rreziqe	Totali
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2010</b>	<b>100,000</b>					<b>413</b>			<b>100,413</b>
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel									
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	<b>100,000</b>					<b>413</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>100,413</b>
Fitimi neto i periudhes kontabel						1,034,020			<b>1,034,020</b>
Dividentet e paguar/deklaruar									0
Transferime ne rezerven e detyrueshme ligjore									0
Transferime ne rezerven e detyrueshme statutore									0
Transferime ne rezerva te tjera						0	0		0
Emetimi i kapitalit aksionar	0	0							0
Rezerva rivleresimi i AAGJ							0		0
Transferim ne detyrimet								0	0
Blerje aksionesh thesari			0						0
Terheqje kapitali per zvogelim									0
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2010</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,034,433</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,134,433</b>

**FORMULARI I URDHËR PAGESËS PËR  
DEKLARIMIN ELEKTRONIK TË TATIMIT MBI  
FITIMIN**
**Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)**


(2) Periudha Tatimore	(1) Numri Serial:	K92129029E33O045
2010		

K92129029E33O045

(3) Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT)	K92129029E
(4) Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm	HYDROBORSH
(5) Emri, Mbiemri, Personi Fizik	
(6) Adresa	Autostrada Tirane-Durres, Kilo TIRANE
(7) Numri i Telefonit:	Tirane, Drejtoria Rajonale Tirane

Data e deklarimit 2011-03-28
**Në bazë të deklarimit tuaj shuma e mëposhteme duhet paguar**

Totali për t'u paguar	0,00
-----------------------	------


**PAGESA**

Vetëm për Përdorim Zyrtar dhe plotësohet nga banka

- Lekë  
 Xhirim  
 Çek  
 Të tjera

Shuma e paguar

Data, Vula dhe Nënshkrimi i nëpunësit të bankës

**TU PAGUA**


Firma e Personit të tatueshëm

*Fatmir Hoxha*  
*Fatmir Hoxha*

**SHPJEGIME LIDHUR  
ME  
PASQYRAT FINANCIARE**

***HYDROBORSH SH.P.K***

***Viti Ushtrimor 2010***

**Tiranë, më 25.03.2011**

# SHËNIME MBI LLOGARITË VJETORE TË VITIT 2010

## I. Të përgjithshme

### Organizimi

Shoqëria “HYDROBORSH” me qendër në Tiranë, Kashar, merret me ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve “Fterre” dhe “Fterre 1” tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia nëpunë, prodhimi, furnizimi, transferimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike në zbatim të kontratës së konçensionit nr.60072 Rep, Nr.2270 Kol datë 31.05.2009.

Kjo kompani është themeluar në datën 28.09.2009.

### Pronësia dhe Pajisjet

Shoqëria e kryen aktivitetin në ambiente që janë marrë me qera. Aktivet Afatgjata Materiale të zotëruara prej saj përbëhen nga pajisje zyre dhe informatike.

### Kapitalet e veta

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek ndërsa kapitalet e veta të shoqërisë janë paraqitur në shumën prej 1.134.433 lek të cilat janë paraqitur në bilanc më 31 Dhjetor 2010 si rezultat i fitimit të perjudhes, realizuar si pasojë e një studimi të tregut shqipëtar të hidroenergjitikës fokusuar në projekte me madhësi mesatare, studim ky i realizuar për një kompani të huaj. HYDROBORSH shpk ka në përbërje të saj tre ortakë me aksione të shprehura në përqindje si më poshtë:

- AGNA sha 55% (pesëdhjet e pesë përqind)
- HYDRO-VALBONA 40% (dyzetë përqind)
- TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT 5% (pesë përqind)

### Administrimi

Shoqëria “HYDROBORSH” drejtohet nga Asambleja e Përgjithëshme dhe Administratorët e shoqërisë. Administratorëve i përkasin të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë..

## II . Politikat kryesore kontabile

### 1. Marrëveshja Kontabël

Deklarimet financiare të bashkangjitura janë përgatitur në bazë të rregjistrimeve kontabël të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit në zbatim të Ligjit nr 9228,



datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Bilanci i fund vitit është paraqitur në një format i cili është në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike dhe konceptit të rregjistrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e njohjes së tyre.

Deklarimet financiare janë shprehur në lek, e cila është monedha shqiptare

## **2- Përmbledhje e politikave kontabël**

Një përmbledhje e pjesës më të madhe të politikave kontabël të reflektuara në deklarimet financiare janë sa më poshtë:

### **2.1 Aktivet e Afatgjata Materiale**

AAM janë mbajtur me koston e blerjes.

### **2.2. Para në dorë dhe në banka**

Paratë në dorë dhe nëbanka perfshin gjendjen e parave me vlerën e tyre.

### **2.3 Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë paraqitur me vlerën e tyre për tu paguar në datën e kryerjes së transaksionit.

## **III. Shënime mbi Llogaritë Vjetore**

### **1. Aktivet Afatshkurtëra Monetare(shënim 1)**

Gjendja e likuditeteve më datë 31 Dhjetor 2010 paraqitet:

	<u><i>31 Dhjetor 2010</i></u>
Para në dorë	983.073
Para ne Banka	1.598.502
<b>Totali</b>	<b><u>2.581.575</u></b>

Shoqëria operon me llogari bankare në leke dhe euro.

Likujditetet janë paraqitur në bilanc me gjendjen e llogarive bankare në datën e fundit të vitit 31.12.2010, e cila është e njëjtë me ekstraktin e fundit të bankës për këtë periudhë si dhe me gjendjen e arkës së shoqërisë në fund të muajit Dhjetor 2010.

## 2. Aktivet afatgjata materiale (shënim 2)

Gjatë periudhës 01 Janar 2010 – 31 Dhjetor 2010, sipas bilancit vjetor të paraqitur janë bërë kontabilizimet blerje të A.A.M për 840.242 lek. Kështu që Vlera e aktiveve paraqitet:

	Pajisje informatike	Pajisje Zyre	Totali
<i>Aktive të Grupëzuara</i>			
Gjendje 01.01.2010	0	0	0
Shtesa	424.418	415.824	840.242
Pakesime (Amortizimi)	-106.262	-46.893	-153.155
<b>Totali</b>	<b><u>318.156</u></b>	<b><u>368.931</u></b>	<b><u>687.087</u></b>

Për vitin 2010 janë bërë shtesa të AAM në pajisje informatike për vlerën 424.418 lek dhe në pajisje zyre për vlerën 415.824 lek të cilat janë pasqyruar në kontabilitet me koston e blerjes. Ndërkohë të dy zerat pajisje zyre dhe informatike janë pakësuar si rezultat i amortizimit gjatë vitit 2010 përkatësisht për vlerat 46.893 lek dhe 143.203 lek. Inventari kontabël më 31.12.2010 për AAM përputhet me tepricat e pasqyruara në bilancin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010.

## 3. Aktivet afatgjata jo-materiale (shënim 3)

Gjatë periudhës 01 Janar- 31 Dhjetor 2010, sipas bilancit vjetor të paraqitur nuk janë bërë blerje të A.A.J.M

## ***Detyrime tatimore***

- Gjendja e detyrimeve tatimore deri në një vit paraqitet:

	<u><i>31 Dhjetor 2010</i></u>
Sigurime shoqerore	23,464
Tatim Page	64,444
Tatim ne burim	<u>28,555</u>
<b>SHUMA</b>	<b><u><u>116,462</u></u></b>

Lidhur me këto detyrime nuk paraqiten probleme.

### **Detyrimet sociale:**

Llogaritë e sigurimeve shoqërore llogariten në bilanc me shumën që janë kalkuluar dhe gjatë vitit 2010.

Këto vlera përputhen me tepricat debitore të llogarive përkatëse.

### **Detyrime ndaj ortakut:**

Në bilancin e vitit 2010 detyrimet ndaj ortakëve paraqiten në vlerën 25.618.155 lek si rezultat i derdhjeve dhe pagesave të bëra prej tyre në euro dhe lek gjatë vitit 2010 .

### **KAPITALI(shenim 4)**

#### **Kapitalet e veta**

Gjendja e Kapitaleve të veta paraqitet për shumën 1.134.433 lek i cili paraqite si më poshtë:

#### **Kapitali i nënshkruar në vlerën 100.000 lek.**

Në postin **Fitime Humbje të Ushtrimit** është pasqyruar rezultati financiar i vitit, për shumën 1.034.020 lek, i cili përputhet me pasqyrën e llogarisë “Fitime Humbje” të bilancit. Në postin Fitimet e pashpërndara është pasqyruar fitimi i mbartur nga viti i kaluar në vlerën 413 lek.

Të ardhurat dhe shpenzimet

Për periudhën 01.01.2010 – 31.12.2010, shoqëria ka realizuar të ardhura të cilat paraqiten në llogarinë e klasës 7 dhe nuk ka të pasqyruara shpenzime si rezultat i transferimit të tyre në AQT në proces të pasojë e investimeve që ajo po bën në ndërtimin e hidrocentraleve.

<b>Të ardhura</b>	<u><i>31.12.2010</i></u>
Nga shitja e shërbimeve	1,067,674
Interesa të fituar	3,028
Fitime nga kusi I këmbimit	78,210
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b><u>1,148,911</u></b>

Shoqëria rezulton me fitim.

## VI. Kontrolli i rregullave dhe metodave kontabel


Jam kujdesur që në plotësimin e posteve të bilancit të llogarisë Fitim e Humbje si dhe të Anekseve, të respektohen parimet themelore të kontabilitetit:

- i kujdesit
- i vazhdimësisë së metodave
- i ndarjes dhe i pavarësisë së ushtrimeve
- i kostos historike
- i përhershmerisë së metodave kontabël
- i rëndësisë kuptimore të informacioneve
- i moskompensimit të posteve të bilancit
- i paprekshmërisë së bilancit të çeljes
- i sinqeritetit dhe vërtetësisë.

Në plotësimin e këtyre parimeve nuk ka shmangie.

Hartuesi i pasqyrave financiare

**Afrim PEÇI**

  
**AFRIM PEÇI**

*Kontabël i Miratuar*

*NR. 1027*

**Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2010**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2010	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2010
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje					0
4	Mjete transporti					0
5	kompjuterike	6	0	424,418	0	424,418
1	Zyre	6	0	415,824		415,824
2						0
3						0
4						0
	<b>TOTALI</b>		0	840,242	0	840,242

**Amortizimi A.A.Materiale 2010**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2010	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2010
1	Toka		0	0		0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje,vegla					0
4	Mjete transporti					0
5	kompjuterike	6	0	424,418	106,262	318,156
1	Zyre	6	0	415,824	46,893	368,931
2						0
3						0
4						0
	<b>TOTALI</b>		0	840,242	153,155	687,087


**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2010**

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2010	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2010
1	Toka		0		0	0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje,vegla					0
4	Mjete transporti					0
5	kompjuterike	6	0	424,418	106,262	318,156
1	Zyre	6	0	415,824	46,893	368,931
2						0
3						0
4						0
	<b>TOTALI</b>		0	840,242	153,155	687,087



ANEKS STATISTIKOR				
	TE ARDHURAT	Numri i Llogarise	Kodi Statistikor	Viti 2010
<b>1</b>	<b>Shitjet gjithsej (a + b +c )</b>	<b>70</b>	<b>11100</b>	<b>1,067,674</b>
a)	Te ardhura nga shitja e Produktit te vet	701/702/703	11101	-
b)	Te ardhura nga shitja e Shërbimeve	704	11102	<b>1,067,674</b>
c)	te ardhura nga shitja e Mallrave	705	11103	-
<b>2</b>	<b>Të ardhura nga shitje të tjera (a+b+c)</b>	<b>708</b>	<b>11104</b>	<b>-</b>
a)	Qeraja	7081	111041	-
b)	Komisione	7082	111042	-
c)	Transport per te tjeret	7083	111043	-
<b>3</b>	<b>Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshëm e prodhimeve në proces :</b>	<b>71</b>	<b>11201</b>	<b>-</b>
	Shtesat (+)		112011	-
	Pakesimet (-)		112012	-
<b>4</b>	<b>Prodhimi per qellimet e vet ndermarrjes dhe per kapital :</b>	<b>72</b>	<b>11300</b>	<b>-</b>
	<i>nga i cili: Prodhim i aktiveve afatgjata</i>		11301	-
<b>5</b>	<b>Të ardhura nga grantet (Subvencione)</b>	<b>73</b>	<b>11400</b>	<b>-</b>
<b>6</b>	<b>Të tjera (interesa bankare + kursi i kembimt)</b>	<b>75</b>	<b>11500</b>	<b>81,240</b>
<b>7</b>	<b>Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata</b>	<b>77</b>	<b>11600</b>	<b>-</b>
<b>l)</b>	<b>Totali i te ardhurave l= (1+2+/-3+4+5+6+7+8)</b>		<b>11800</b>	<b>1,148,913</b>

Administratori  
 Fatmir Hoxha




ANEKS STATISTIKOR

SHPENZIMET		Numri i Llogarise	Kodi Statistikor	Viti 2010	Viti 2009
<b>1</b>	<b>Blerje, shpenzime (a+/-b+c+/-d+e)</b>	<b>60</b>	<b>12100</b>	-	-
a)	Blerje/shpenzime materiale dhe materiale të tjera	601+602	12101	-	-
b)	Ndryshimet e gjëndjeve të Materialeve (+/-)		12102	-	-
c)	Mallra të blera	605/1	12103	-	-
d)	Ndryshimet e gjëndjeve të Mallrave (+/-)		12104	-	-
e)	Shpenzime për shërbime	605/2	12105	-	-
<b>2</b>	<b>Shpenzime për personelin (a+b)</b>	<b>64</b>	<b>12200</b>	-	-
a-	Pagat e personelit	641	12201	-	-
b-	Shpenzimet për sig.shoqërore dhe shëndetsore	644	12202	-	-
<b>3</b>	<b>Amortizimet dhe zhvlerësimet</b>	<b>68</b>	<b>12300</b>	-	-
<b>4</b>	<b>Shërbime nga të tretë (a+b+c+d+e+f+g+h+i+j+k+l+m)</b>	<b>61</b>	<b>12400</b>	-	-
a)	Shërbimet nga nen-kontraktoret		12401	-	-
b)	Trajtime të përgjithshme	611	12402	-	-
c)	Qera	613	12403	-	-
d)	Mirembajtje dhe riparime	615	12404	-	-
e)	Shpenzime për Sigurime	616	12405	-	-
f)	Kerkim studime	617	12406	-	-
g)	Shërbime të tjera	618	12407	-	-
h)	Shpenzime për koncesione, patenta dhe licenca	623	12408	-	-
i)	Shpenzime për publicitet, reklama	624	12409	-	-
j)	Transferime, udhetime, dieta	625	12410	-	-
k)	Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	626	12411	-	-
l)	Shpenzime transporti	627	12412	-	-
	per Blerje	6271	124121	-	-
	per shitje	6272	124122	-	-
m)	Shpenzime për shërbime bankare	628	12413	-	-
<b>5</b>	<b>Tatime dhe taksa (a+b+c+d)</b>	<b>63</b>	<b>12500</b>	-	-
a)	Taksa dhe tarifa doganore	632	12501	-	-
b)	Akciza	633	12502	-	-
c)	Taksa dhe tarifa vendore	634	12503	-	-
d)	Taksa e regjistrimit dhe tatime të tjera	635+638	12504	-	-
II)	<b>Totali i shpenzimeve II=(1+2+3+4+5)</b>		12600	-	-
<b>Informatë:</b>				<b>Viti 2010</b>	<b>Viti 2009</b>
<b>1</b>	<b>Numri mesatar i të punësuarve</b>		<b>14000</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Investimet</b>		<b>15000</b>	<b>840,242</b>	<b>-</b>
a)	Shtimi i aseteve fikse		15001	840,242	-
	nga të cilat: asete të reja		150011	840,242	-
b)	Pakesimi i aseteve fikse		15002	-	-
	nga të cilat shitja e aseteve ekzistuese		150021	-	-

Administratori

Fatmir Hoxha





		Aktiviteti	Te ardhurat nga aktiviteti
1	Tregti	Tregti karburanti	0
2	Tregti	Tregti ushqimore,pije	0
3	Tregti	Tregti materiale ndertimi	0
4	Tregti	Tregti cigaresh	0
5	Tregti	Tregti artikuj industrial	0
6	Tregti	Farmaci	0
7	Tregti	Eksport mallrash	0
8	Tregti	Tregti te tjera	0
I		<b>Totali i te ardhurave nga tregtia</b>	<b>0</b>
9	Ndertim	Ndertim banese	0
10	Ndertim	Ndertim pune publike	0
11	Ndertim	Ndertime te tjera	0
II		<b>Totali i te ardhurave nga ndertimi</b>	<b>0</b>
12	Prodhim	Eksport, prodhime te ndryshme	0
13	Prodhim	<b>Fason te cdo lloji</b>	0
14	Prodhim	Prodhim materiale ndertimi	0
15	Prodhim	Prodhim ushqimore	0
16	Prodhim	Prodhim pije alkolike, etj	0
17	Prodhim	Prodhime energji	0
18	Prodhim	Prodhim hidrokarbure,	0
19	Prodhim	Prodhime te tjera	0
III		<b>Totali i te ardhurave nga prodhimi</b>	<b>0</b>
20	Transport	Transport mallrash	0
21	Transport	Transport malli nderkombetare	0
22	Transport	Transport udhetaresh	0
23	Transport	Transport udhetaresh nderkombetare	0
IV		<b>Totali i te ardhurave nga transporti</b>	<b>0</b>
24	Sherbimi	Sherbime financiare	0
25	Sherbimi	Siguracione	0
26	Sherbimi	Sherbime mjekesore	0
27	Sherbimi	Bar restorante	0
28	Sherbimi	Hoteleri	0
29	Sherbimi	Lojra Fati	0
30	Sherbimi	Veprimtari televizive	0
31	Sherbimi	Telekomunikacion	0
32	Sherbimi	Eksport sherbimish te ndryshme	0
33	Sherbimi	Profesione te lira	0
34	Sherbimi	Sherbime te tjera	1,148,913
V		<b>Totali i te ardhurave nga sherbimet</b>	<b>1,148,913</b>
		<b>TOALI (I+II+III+IV+V)</b>	<b>1,148,913</b>

Te punesuar mesatarisht per vitin 2010:	Nr. I te punesuarve
Me page deri ne 19.000 leke	0
Me page nga 19.001 deri ne 30.000 leke	0
Me page nga 30.001 deri ne 66.500 leke	0
Me page nga 66.501 deri ne 84.100 leke	0
Me page me te larte se 84.100 leke	2
<b>Totali</b>	<b>2</b>

Shenim: Kjo pasqyre plotesohet edhe on-line.



## DEKLARATË

Deklaroj se **Shoqëria** HYDROBORSH sh.p.k me **NIPT** K92129029E me administrator Z.Fatmir Hoxha dhe **aksionere**:

1. Shoqëria HYDRO-VALBONA me NIPT K81722018P përqindja e pjesëmarrjes 40% (dyzetë përqind)
2. Shoqëria AGNA me NIPT J62903631L përqindja e pjesëmarrjes 55% (pesëdhjetë e pesë përqind)
3. Shoqëria TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT me NIPT\_J82427007R\_përqindja e pjesëmarrjes 5% (pesë përqind)


ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2010 komform standarteve kombëtare të kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare është:

Z. Afrim Peçi (**kontabël i miratuar** ) me NIPT **K31623072G**

**Administratori i Shoqërisë**

**Fatmir Hoxha**



# KONTRATË QIRAJE

Nr. 1126, Datë : 30 / 11 / 2010

**Baza ligjore:** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 140, datë 13.2.2008 “Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme të sekuestruara në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 314, dt. 05.05.2010 “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërblimit ,të personave të tretë në administrimin e pasurisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 27, dt.23.9.2008 “Për Procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve, rregullat për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve dhe të ardhurave dhe procedurat e kontraktimit të personelit të jashtëm dhe shërbimeve të tjera”.

## 1. HYRJE

Në regjistrin hipotekor Tirane në pronësi të “Abdyl Latif Saleh” shpk , figuron i regjistruar një objekt (pasuria, apartament nr.1, kati IV, me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, me adresë: **Bulevardi Dëshmorët e Kombit,Twin Towers 2, Tiranë**, sekuestruar me urdhërin e Ministrit të Financave **nr.2,date 3.12.2004**, është në administrim të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Tiranë.

## 2. PALËT

Në kuptimin e kësaj kontrate qiraje, e cila që këtu dhe më pas referohet si kontratë, palët janë:

- 2.1. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përfaqësuar nga Kryeadministratori **Z.Besnik Çobaj**, i datlindjes **26.02.1970**, lindur në Shkodër dhe banues në Tirane, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi **letërnjoftim nr.024621765**, referuar në këtë kontratë me cilësinë e **QIRADHËNËSIT**.
- 2.2. Personi juridik, “**HYDROBORSH**” shpk, me seli **Tiranë, Autostrada Tirane-Durres,Km1,Godina Agna**, me nr.**NIPT K92129029E**, përfaqësuar nga z. **Fatmir Hoxha**, administrator, i datlindjes **07.05.1954**, lindur në Shkodër dhe banues në **Tiranë**, me shtetësi **Shqiptare**, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi , **letërnjoftim nr.024464886** , referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

## 3. OBJEKTI

- 3.1 Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira nga ana e qiradhënësit dhe marrja me qira nga ana e qiramarrësit të objektit të përmendur në nenin (1) të kësaj kontrate, i cili përbëhet nga: **apartamenti nr.1, kati 4, me sip.94 m<sup>2</sup>,pjesë e pronës të përmendur në pikën 1 të kësaj kontrate.**
- 3.2. Objekti është në gjendje të rregullt.
- 3.3. Mbështetur në bazën ligjore të cituar, kushtet kontraktuale për të cilat palët bien dakort, janë si më poshtë:

## 4. AFATI I KONTRATËS

- 4.1. Kjo kontratë qiraje lidhet me afat një vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës **01.12.2010, deri në datën 30.11.2011**, me të drejtë rinovimi.
- 4.2. Në datën e mbarimit të kësaj kontrate, nëse palët nuk bien dakort për rinovimin e saj, objekti do t'i dorëzohet Qiradhënësit.

## 5. ÇMIMI I QIRASË DHE MËNYRA E PAGESËS

- 5.1. Palët bien dakort që çmimi i qirasë të jetë **126 900 (njëqind e njetzet e gjashte mijë e nentëqind) LEKE / 1 MUAJ.**
- 5.2. Qiramarrësi do ti paguajë Qiradhënësit shumën prej **114 210 (njëqind e katermbëdhjetemijë e dyqind e dhjetë) LEKE / 1 MUAJ**, e cila është sa vlera e qirasë, pasi t'i zbritet shuma prej 10% si tatim në burim.
- 5.3. Në rast të rinovimit të kontratës, çmimi i qirasë dhe mënyra e pagesës do të negociohen midis palëve.
- 5.4. Pagesa bëhet parapagim çdo muaj brenda datës 5 të çdo muaji. Për muajin e parë të kontratës pagesa bëhet në ditën e nënshkrimit të kontratës dhe shuma për t'u paguar llogaritet në proporcion me ditët e këtij muaji.
- 5.5. Për cdo ditë vonesë nga data caktuar Qiramarrësi do t'i paguajë Qiradhënësit 0.1% te shumës së qirasë mujore si kamatë vonese, por vonesa nuk mund të jetë më e madhe se 15 ditë kalendarike.
- 5.6. Brenda 5 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, Qiramarrësi do ti paguajë Qiradhënësit një shumë sa çmimi i qirasë mujore e cila do të jetë si garanci për dëmët e mundshme të shkaktuara nga Qiramarrësi në objekt dhe për çmimin e papaguar të qirasë sipas pikës 5.5 të kësaj kontrate. Nëse nuk ka dëme dhe Qiramarrësi ka qenë korrekt me pagesat, kjo shumë i kthehet Qiramarrësit brenda 15 ditëve të dorëzimit të objektit.
- 5.7. Pagesat për Qiradhënësin bëhen pranë llogarisë **“Të ardhura dhe shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të komfiskuara në administrim të AAPSK”**, me nr **.2022330701 Lekë** në bankën **Intesa San Paolo Bank** dhe vërtetohen me dokumentin bankar përkatës.
- 5.8. Pagesat për tatimin në burim bëhen në llogaritë e autorizuara nga organet tatimore për këtë qëllim. Qiramarrësi do t'i vërtetojë Qiradhënësit pagesat e tatimit në burim me anë të dokumentit bankar përkatës.

## 6. DESTINACIONI I PËRDORIMIT TË OBJEKTIT

- 6.1. Destinacioni i përdorimit të objektit është : **për zyrë**
- 6.2. Qiramarrësi nuk mund të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objektit, pa marrë pëlqimin paraprak të Qiradhënësit.

## 7. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE.

- 7.1. Qiramarrësi ka të drejtë të përdorë objektin e marrë me qira pa bërë ndryshime të rëndësishme arkitektuale apo shtesa në objekt. Për cdo ndryshim duhet të marrë pëlqimin e Qiradhënësit.
- 7.2. Qiramarrësi është i detyruar që të paguajë shpenzimet për energji elektrike, ujë, administrim të ambienteve të përbashkëta, për cdo muaj si dhe çdo detyrim tjetër që lind nga përdorimi i objektit që nga momenti i lidhjes së kontratës dhe gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj.
- 7.3. Në raste të tilla si tërmet, luftë, përmytje, forca madhore, të cilat dëmtojnë objektin dhe ndërpresin tërë jetën ekonomike e sociale të vendit dhe të qytetit , kjo kontratë quhet e prishur dhe asnjë nga palët nuk mban përgjegjësi.
- 7.4. Në rast se Qiradhënësi, për shkaqe ligjore heq dorë nga administrimi i pasurisë, ai mund të kërkojë në çdo kohë prishjen e kontratës.

## 8. DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

- 8.1. Qiradhënësi duhet ti dorëzojë Qiramarrësit objektin në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike për të cilën kanë kontraktuar me njëri-tjetrin.
- 8.2. Të garantojë Qiramarrësin gjatë gjithë periudhës për të cilën është kontraktuar për shqetesimet që mund të lindin nga të tretët, të cilët mund të pretendojnë se kanë të drejta mbi këtë objekt.
- 8.3. Qiradhënësi është i detyruar të njoftojë menjëherë Qiramarrësin për çdo ndryshim eventual të kushteve të kësaj kontrate.

- 8.4. Qiradhënësi nuk mban përgjegjësi në qoftë se Qiramarrësi kryen një aktivitet i cili është i kundraligjshëm. Në rast se nga ky aktivitet i kundraligjshëm bllokohet, apo dëmtohet ambjenti, Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit dëmin e shkaktuar.

## 9. DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

- 9.1. Të marrë në dorëzim objektin brenda afatit të caktuar dhe ta përdorë atë sipas destinacionit të parashikuar në këtë kontratë.
- 9.2. Të bëjë pagesat në shumën dhe afatin e caktuar në kontratë.
- 9.3. Qiramarrësi duhet të kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objektit dhe përgjigjet për çdo dëmtim që i sjell objektit.
- 9.4. Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë Qiradhënësit objektin në gjendjen në të cilën e ka marrë dhe në afatin e caktuar në kontratë.
- 9.5. Qiramarrësi nuk ka të drejte të japë objektin me qira.
- 9.6. Qiramarrësi është i detyruar të zhdëmtojë Qiradhënësin për dëmet që i ka shkaktuar objektit brenda afateve të parashikuara në këtë kontratë.
- 9.7. Qiramarrësi nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrime që Qiradhënësi mund të ketë ndaj personave të tretë.

## 10. ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 10.1. Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë kontratë qiraje kur :
- 10.1.1. Qiramarrësi nuk paguan qiranë në shumën dhe afatin e caktuar sipas pikës 5 të kësaj kontrate.
- 10.1.2. Qiramarrësi ndryshon destinacionin e përdorimit të objektit nga ai i parashikuar në kontratë, pa pëlqimin e Qiradhënësit.
- 10.1.3. Konstaton se Qiramarrësi ka dëmtuar rëndë objektin e marrë me qira.
- 10.1.4. Për shkaqe ligjore heq dorë nga administrimi i objektit të kësaj kontrate.
- 10.2. Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë duke njoftuar Qiradhënësin tre muaj përpara dhe duke paguar një penalitet që është sa çmimi mujor i qirasë.
- 10.3. Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje duke njoftuar një muaj përpara, kur Qiradhënësi nuk garanton për shqetesimet që mund të lindin nga të tretë, të cilët pretendojnë se kanë të drejta mbi këtë objekt.
- 10.4. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur me plotësimin e afatit të saj dhe në qoftë se nuk është rinovuar.
- Përvec palëve kontraktuese askush nuk ka asnjë të drejtë të zgjidhë këtë kontratë para mbarimit të afatit të caktuar apo të kërkojë ndryshimin e kushteve të vëna në këtë kontratë, përveç se me marrveshje me shkrim midis palëve.

## 10. MËNYRAT E KOMUNIKIMIT

- 11.1. Mënyra e komunikimit mes palëve kontraktuese do të jetë me shkrim në adresat e mëposhtme :

Qiradhënësi : **Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.  
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Twin Towers 2, Apt 2, kati 12, Tiranë.  
Tel/Faks : 04 2280 207**

Qiramarrësi: **Adresa : "HYDROBORSH" me seli, Autostrada Tirane-Durres,Km1,Godina  
Aгна Group, tel. 0682050440**

- 11.2. Për çdo ndryshim të këtyre adresave, palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën me shkrim.

**12. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Për çdo mosmarrëveshje, e cila nuk do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, palët mund t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

**13. NËNSHKRIMI**

Kjo kontratë u hartua në 2 kopje me vlerë të njëjtë dhe pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre. Secila palë merr nga një kopje dhe një kopje qëndron në arshivën e AAPSK.

**PALËT**

**QIRADHËNËSI**

**Agjensia për Administrimin e Pasurive të  
Sekuestruara dhe të Konfiskuara  
KRYEADMINISTRATOR**

**Besnik ÇOBAJ**



**QIRAMARRËSI**

**“HYDROBORSH”  
ADMINISTRATOR**

**Fatmir HOXHA**

